



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr 87 datë 30.10.2016

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo rregullore bën organizimin dhe realizimin e veprimtarisë së Këshillit të Bashkisë Korçë, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 " për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 8480 dt. 27.05.1999 "per funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shteterore dhe enteve publike", te Ligjit 8485 dt. 12.5.1999 " Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, deri ne hyrjen ne fuqi te ligjit 44/2015 dt. 30.04.2015, Kodi i Proceduarave Administrative, Ligji 44/2015, dt. 30.04.2015, Kodi i Proçeduarave Administrative, pas hyrjes në fuqi të tij, Ligji 9887 dt. 10.03.2008 " për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, Ligji 119/2014 dt. 18.09.2014 " për të drejtën e informimit".

Këshilli i Bashkisë me vendime të veçanta zgjidh edhe ato probleme që nuk janë parashikuar në këtë rregullore.

II. KONSTITUIMI I KËSHILLIT BASHKIAK

Neni 2

-Sekretari i Këshillit të Bashkisë, thërret mbledhjen e parë të Këshillit, jo me vonë se 20 ditë nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve, nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Në mungesë të tij mbledhja e parë thirret sipas parashikimeve të n. 26 te Ligjit, 8652 dt. 31.07.2000 "për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar.

-Mbledhja e parë e K.B është e vlefshme, kur në të marrin pjesë, më shume se gjysma e anëtarëve të tij, të shpallur nga Komisioni i Zgjedhjeve për Qeverisjen Vendore. Nëse nuk mblidhen më shumë se gjysma e anëtarëve të KB, mbledhja nuk zhvillohet dhe ajo thirret tre ditë më vonë, por jo më shumë se tre herë. Në

rastet kur edhe pas tri herë thirrje, nuk sigurohet pjesëmarrja e kërkuar, Këshilli konsiderohet i shpërndarë.

-Drejtmin e mbledhjes së parë e realizon këshilltari më i vjetër, deri në zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Bashkiak. Ai ndihmohet nga Sekretari i Këshillit të Bashkisë.

### Neni 3 (Mbledhja e parë e KB)

Këshilli në mbledhjen e parë të tij, zgjedh nga rradhet e veta, komisionin e mandateve, i përberë nga 3 anëtarë, i cili do bëjë verifikimin e mandateve të Këshilltarëve.

Propozimet për përbërjen e komisionit të mandateve, bëhen nga përfaqësuesit e grupimeve politike dhe miratohen nga këshilli me votim të hapur, me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës të të gjithë anëtarëve të tij.

Pjesëmarrja dhe raporti i këshilltarëve në këtë komision, do jetë i njëjtë me raportin e përfaqësimit të grupimeve politike në këshill.

Kohëzgjatja e Komisionit të mandateve, është e njëjtë me kohëzgjatjen e Këshillit Bashkiak.

Komisioni i mandateve:

- verifikon dokumentacionin dhe kushtet ligjore për zgjedhjen e çdo këshilltari,
- harton raportin e mandateve
- propozon para këshillit vërtetimin ose heqjen e mandatit të këshilltarit.

Vërtetimi ose heqja e mandatit të këshilltarit, bëhet me shumicën e votave, të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Këshilltari nuk mund të votojë për mandatin e tij.

Mbarimi i mandatit të këshilltarit para afatit bëhet sipas parashikimit të n.27/4 i Ligjit 8652 dt. 31.07.2000 "për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar.

### Neni 4

1.Pas verifikimit të mandateve nga Komisioni përkatës, këshilltarët betohen.

Formulën e betimit e lexon Këshilltari që drejton mbledhjen.

Teksti i betimit:

" Betohem në emër të zgjedhësve që përfaqësoj, të mbroj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjet e saj. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Korçë dhe do të punoj me ndershmeri dhe përkushtim për zhvillimin e rritjen e mirëqënies së tyre".

2. Këshilltari që nuk pranon të bëjë betimin dhe ta nënshkruaje atë, quhet se jep dorëheqjen dhe atij nuk i jepet mandati.

3. Këshilltari që mungon në seancën kur bëhet betimi, betohet në seancën me të parë, në të cilën merr pjesë.

4. Në rastet kur Këshilltari tërhiqet nga funksioni i tij, ai e deklaron dorëheqjen e tij me shkrim dhe për zëvendësimin e tij, Komisioni i mandateve i paraqet Këshillit kandidatin e radhës, së listës shumëemërore të të njëjtit subjekt elektoral në të cilin, bën pjesë këshilltari që largohet.

5. Të drejtat e këshilltarit janë ato të parashikuara në n. 29 të Ligjit 8652 dt. 31.07.2000 " për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar

### III. ORGANET DREJTUESE TË KËSHILLIT BASHKIAK

#### Neni 5 (Zgjedhja dhe shkarkimi i Kryetarit të KB)

Këshilli Bashkiak zgjedh Kryetarin e KB, Nënkryetarin e KB, si dhe anëtarët që do përfaqësojnë KB në Këshillin e Qarkut.

Organe të tjera pranë këshillit janë edhe Komisionet e Përhershme dhe të Posaçme të KB.

#### Neni 6

Zgjedhja e Kryetarit të KB, bëhet nga rradhët e këshilltarëve të KB, me propozim të secilit prej grupimeve politike, në mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak.

Nëse ka më shumë se një kandidaturë për kryetar të KB, votimi bëhet i fshehtë, dhe kryetar zgjidhet ai që ka marrë shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës të të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar, vijohet në një raund të dytë, ku votohet për dy kandidaturat që kanë marrë më shumë vota.

Votimi organizohet nga një komision votimi i cili përbëhet nga 3 ose 5 anëtarë, që pasqyrojnë përbërjen politike të këshillit.

Anëtari më i vjetër në moshë, kryhen edhe detyrën e kryetarit të komisionit të votimit dhe shpall rezultatin e votimit.

Drejtuesi i seancës, fton Kryetarin e Këshillit Bashkiak të zgjedhur, të vijojë me drejtimin e mbledhjes së parë, të Këshillit Bashkiak, me zgjedhjen e organeve të tjera drejtuese.

Propozimi për shkarkimin e Kryetarit të KB bëhet nga të paktën 1/3 e anëtarëve të Këshillit.

Propozimi për shkarkimin e Kryetarit të KB, i nënshtrohet votimit të fshehtë dhe miratohet me shumicë të cilësuar (me 3/5 e gjithë anëtarëve të Këshillit Bashkiak).

#### Neni 7 (Zgjedhja dhe shkarkimi i nënkryetarit të KB)

Pas zgjedhjes së Kryetarit të Këshillit të Bashkisë, vijohet me zgjedhjen e nënkryetarit të këshillit Bashkiak. Numri i nënkryetarëve të K. Bashkiak, propozohet

nga grupimet politike dhe miratohet me votim të hapur. Varianti i propozuar për numrin e nënkryetarëve, të KB, që merr më shumë vota, përcakton edhe numrin e nënkryetarëve të KB që do të zgjidhen.

Secili grupim politik propozon emra, sipas numrit të nënkryetarëve.

Nëse numri i emrave të propozuara përputhet me nr. e nënkryetarëve që duhet të zgjidhen, votimi bëhet i hapur.

Nëse nr. i kandidaturave për nënkryetar të KB është më i madh se numri i nënkryetarëve që duhet të zgjidhen, votimi bëhet i fshehtë, dhe nënkryetar zgjidhen ata që kanë marrë shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës të të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar, vijohet në një raund të dytë, ku votohet për kandidaturat që kanë marrë më shumë vota.

Propozimi për shkarkimin e tyre bëhet nga të paktën 1/3 e anëtarëve të Këshillit.

Propozimi për shkarkimin e nënkryetarit të KB, i nënshtrohet votimit të fshehtë dhe miratohet me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

Neni 8 (Emërimi dhe shkarkimi i sekretarit të KB)

Sekretari i Këshillit të Bashkisë emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Bashkisë, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Shkarkimi i tij mund të propozohet edhe nga 1/3 e këshilltarëve.

Neni 9 (Detyrat e Kryetarit të KB)

Kryetari i Këshillit ka këto detyra:

- Thërret mbledhjet e Këshillit të Bashkisë
- Drejton mbledhjet e Këshillit Bashkiak
- Nënshkruan aktet që miraton Këshilli
- Përcakton rendin e ditës për mbledhjet e KB, në bazë të propozimeve të grupimeve politike.
- Ndhmon në kryerjen e rregullt të veprimtarisë së Komisioneve të Këshillit
- Përfaqëson Këshillin e Bashkisë në marrëdhënie me të tretët.
- Paraqet para Këshilltarëve, projekt-vendimet, projekt-urdhërat dhe propozimet e tjera që i kanë ardhur Këshillit.
- Siguron mbarëvajtjen e mbledhjeve të Këshillit, duke vendosur rregullin në sallën e mbledhjes, në zbatim të kësaj Rregulloreje dhe Kodit të Etikës.
- Vërteton saktësinë dhe firmos procesverbalet dhe protokollat e mbledhjeve të këshillit, së bashku me sekretarin.
- Përcakton së bashku me drejtuesit e grupimeve politike, vendodhjen në sallë të Nënkryetarit, si dhe të ftuarve.
- Bën apelin e këshilltarëve

Marrëdhëniet e KB me Bashki të tjera ,brenda dhe jashtë vendit organizohen nga Kryetari i KB në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që përcaktojnë këtë veprimtari dhe në përputhje me Buxhetin që disponon vetë Këshilli.

Përcaktimi i grupeve përfaqësuese në këto raste, bëhet nga Këshilli në bazë të propozimeve të grupimeve politike, në mbledhjet e tij të rradhës.

#### Neni 10 (Detyrat e nënkryetarit të KB)

Në mungesë të kryetarit të KB , detyrat e tij i kryen nënkryetari. Nëse ka me shumë se një nënkryetar, Kryetari i KB, cakton paraprakisht zëvendesin e tij për në mbledhjen e ardhshme dhe nëse kjo nuk është e mundur, detyrat i kryhen ai nënkryetar që i përket grupimit më të madh politik.

Nënkryetari krahas zëvendesimit të Kryetarit të KB, mund të jetë pjesë e komisioneve të përhershme apo të përkohshme , qoftë edhe drejtues, në jo më shumë se i 1 komisioni.

#### Neni 11 (Detyrat e Sekretarit të KB)

Sekretari i Këshillit Bashkiak ka këto detyra:

- Mbjajtjen e dokumentacionit zyrtar të këshillit.
- Ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve , sipas rendit të ditës.
- Njofton këshilltarët për zhvillimin e mbledhjes dhe u dërgon atyre materialet e mbledhjes.
- Shpall dhe publikon njoftimet dhe aktet e nxjerra nga Këshilli.
- Përgatitjen e seancave të këshillimit me Bashkinë.
- Mbikqyr respektimin e rregullores së Këshillit dhe zbatimin e kodit të etikës.
- Kryhen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga vetë Këshilli, apo nga kjo rregullore.

#### Neni 12 (Grupimet e këshilltarëve)

Këshilltarët mund të formojnë grupe, në përputhje me përkatësinë partiake, apo orientimin e tyre politik.

Numri minimal i këshilltarëve për formimin e një grupi duhet të jetë 5 këshilltarë. Nuk mund të formohen grupe këshilltaresh në bazë të interesave etnike, fetare, dhe profesionale.

#### Neni 13

Çdo grup paraqet tek kryetari i KB, vendimin e formimit të grupimit, listen e këshilltarëve, anëtarë të tij si dhe të drejtuesve të grupimit.

Kryetari i KB, shpall krijimin e grupit dhe drejtuesit e tij, në mbledhjen e KB.

Grupimet e këshilltarëve dhe ndryshimet në përbërjen e tyre dhe të drejtimit të tyre, mbahen në një regjistër të veçantë, i cili është pjesë e dokumentacionit që administrohet nga sekretari i Këshillit.

#### Neni 14 (Pjesëmarrja dhe largimi i këshilltarit nga grupimi )

Cdo keshilltar mund te marre pjese ne nje grupim keshilltaresh. Kushtet per anetaresine ne kete grupim, per largimin si dhe te drejtat dhe detyrat e anetareve ne grupim, percaktohen nga vete grupimi, ne perputhje me kerkesat ne teresi te kesaj rregulloreje.

Këshilltari mund të largohet nga grupimi, mbasi bën kërkesë me shkrim para drejtuesve të grupimit, duke njoftuar edhe Kryetarin e KB.

#### Neni 15 (Përfaqësimi i grupimit në Këshill)

Grupimi i këshilltarëve përcakton këshilltarët që do diskutojnë në emër të tyre si dhe rradhën e tyre.

Ky rregull, nuk kufizon të drejtën e çdo këshilltari pjesë e një grupimi, të diskutojë individualisht, kur një të drejtë të tillë e ka kërkuar para kryetarit të KB.

#### Neni 16 (Komisionet e përhershme dhe të posaçme të KB)

Komisionet e Këshillit Bashkiak janë të përhershme dhe të posaçme me karakter të perkohshëm ose jo.

Komisionet e përhershme shqyrtojnë sipas përkatësisë projekt vendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje në Këshill.

Komisionet e posaçme kanë karakter të perkohshëm ose jo dhe krijohen sipas nevojave të këshillit si dhe për çështje të rëndësive të veçanta.

#### Neni 17 (Komisionet e përhershme të KB)

Komisionet e përhershme të KB janë:

1. Komisioni per çështjet ligjore dhe pronat
2. Komisioni për ekonominë dhe financat, buxhetin dhe investimet
3. Komisioni per rregullimin dhe menaxhimin e territorit dhe urbanistikën
4. Komisioni për artin, kulturën, arsimin dhe sportin
5. Komisioni për ndihmën ekonomike, strehimin dhe politikat sociale
6. Komisioni për menaxhimin e shërbimeve
7. Komisioni për veprimtarinë prodhuese, bujqësinë, tregtinë, turizmin dhe mjedisin

#### Neni 18 (Komisionet e posaçme të KB)

Komisionet e posaçme të KB janë:

1. Komisioni për verifikimin e mandateve
2. Komisioni për rregulloren e KB
3. Komisioni për etikën dhe disiplinën
4. Komisioni për dhënien e titujve dhe stimujve
5. Komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve

## Neni 19 (Ndryshimi i numrit të komisioneve)

Numri i përgjithshëm i komisioneve të përhershme apo edhe të posaçme mund të ndryshojë me propozim të 1/3 të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve.

Ndryshimi i numrit të komisioneve, dhe mënyra e drejtimit të komisioneve të reja të krijuara, do ruajë raportin e grupimeve politike, qoftë në drejtimin e tyre, qoftë në përbërjen e anëtarësisë së tyre, si ato të përcaktuara në n.20 të kesaj rregulloreje.

## Neni 20 (Përbërja e komisioneve, mënyra e zgjedhjes së tyre)

Komisionet e përhershme dhe të posaçme, përbëhen nga 5 anëtarë secili. Për komisione të caktuara nga Këshilli Bashkiak, numri i anëtarëve mund të jetë edhe 7 (shtatë).

Numri i komisioneve të përhershme dhe të posaçme, përkatësisht, që do drejtohet me shumicë anëtarësh, nga nje grupim politik, do përcaktohet në bazë të raportit që këto grupime politike kanë në KB.

Raporti i përfaqësimit të grupimeve politike, në anëtarësinë e komisionit, do ruajë raportin që këto grupime politike kanë në KB.

Pra raporti i grupimeve shumicë/pakicë në KB, do ruhet si në ndarjen e numrit të komisioneve , po ashtu edhe në numrin e anëtarëve brenda komisionit.

Në komisionet që do drejtohen nga grupimi politik në pakicë brenda KB, numri i anëtarëve brenda këtyre komisioneve do ketë raport të përmbysur.

Propozimet për llojin e komisioneve që do drejtohen nga secili grupim politik, (sipas raportit të përcaktuar më sipër), bëhen nga drejtuesit e secilit grupim politik dhe votohen, me votim të hapur në mbledhjen e KB.

Propozimet e emrave të këshilltarëve që do marrin pjesë në secilin komision propozohen nga drejtuesit e grupimeve politike dhe votohen me votim të hapur në mbledhjen e KB.

Numri i komisioneve që drejtohen nga grupimet politike si dhe anëtarësia brenda tyre, votohen me shumicën e këshilltarëve të pranishëm.

## Neni 21 (Struktura e Komisioneve të përhershme dhe të posaçme)

Komisionet e përhershme dhe të posaçme zgjedhin, kryetarin dhe zëvendësin e tij.

## Neni 22 (Largimi i këshilltarëve nga komisionet)

Anëtarët e çdo komisioni, për arsye të përligjura dhe me miratim të Kryetarit të KB, mund të largohen nga komisioni ku ata bëjnë pjesë. Zëvendësimi i tyre, bëhet nga këshilltarë të tjerë që i përkasin të njëjtit grupim politik.

## Neni 23 (Përkatësia nëpër komisione)

Çdo këshilltar mund të zgjidhet anëtari i dy ose më shumë komisioneve, por jo me tepër se në 3 komisione të përhershme dhe jo me tepër se në 1 komision të posaçëm.

Me përjashtim të Kryetarit të KB, të gjithë këshilltarët e tjerë mund të jenë pjesë e komisioneve të përhershme apo të posaçme.

Çdo këshilltar mund të kërkohet si ekspert nga një komision i përhershëm, kur nuk bën pjesë në të.

Në komisionet e përhershme mund të përfshihen edhe specialistë që nuk janë këshilltarë, por jo si anëtarë komisioni.

Neni 24 (Bashkërendimi i punës midis komisioneve)

Drejtuesit e komisioneve koordinojnë punën dhe mbajnë lidhje me drejtuesit e komisioneve të tjera si dhe me drejtuesit e Këshillit Bashkiak.

Neni 25 (Detyrat e komisioneve të përhershme)

Komisionet e përhershme shqyrtojnë materialet e paraqitura nga departamentet e ekzekutivit dhe përgatisin me ndihmën e sekretarit të KB, projekt- vendime, projekt-rregullore, projekt-urdhëresa dhe ja paraqesin KB, për shqyrtim dhe miratim.

Komisionet e përhershme diskutojnë projektet e përgatitura, përgatisin raport në lidhje me to ,dhe i propozojnë Këshillit pranimin ose jo të projekteve për miratim, ndryshimin dhe plotësimin e tyre.

Komisionet e përhershme studiojnë dhe analizojnë efektivitetin e akteve në fuqi (vendime, urdhëresa apo rregullore).

Komisionet e përhershme shqyrtojnë raportet, njoftimet dhe relacionet që paraqet para Këshillit , Kryetari i Bashkisë apo zëvendesi i tij, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve dhe institucioneve në varësi të Bashkisë.

Neni 26 (Paraqitja e materialeve para komisioneve të përhershme)

Nëpunësit e administratës së Bashkisë si dhe ata të ndërmarrjeve dhe institucioneve nëvarësi të Bashkisë, janë të detyruara jo vetëm të përgatisin materialet e plota, por duhet domosdoshmërisht të përfaqësohen para komisioneve me qëllim shpjegimin e tyre nëse është nevoja, apo dhënien e specifikimeve teknike në lidhje me to.

Materialet që përgatiten për t'u paraqitur në Këshill, nëpërmjet komisioneve të përhershme, duhet të destinohen nga ana e të sipërpërmendurve, drejt komisioneve përkatëse ku ato duhet të shqyrtohen, në formë elektronike, si dhe në një kopje të printuar.

Materialet që do shqyrtohen nga Komisionet duhet të paraqiten para tyre të premtën e parafundit të çdo muaji, para çdo mbledhje të radhës.



Për mbledhjet jashtë radhe të KB, materialet duhet të paraqiten para komisioneve 1 ditë para zhvillimit të mbledhjes të KB.

Neni 27 (mbledhja e komisioneve të përhershme)

Komisioni i përhershëm mblidhet të martën e fundit të çdo muaji, 2 ditë para mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak.

Komisioni thirret nga kryetari dhe zëvendësi i tij me iniciativën e tyre si dhe me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të Komisionit, ose me urdhër të Kryetarit të KB.

Për mbledhjet jashtë radhe, komisionet mblidhen 1 ditë para zhvillimit të mbledhjes së KB.

Mbledhjet e komisioneve janë të vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren, si rregull, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, me votim të hapur.

Neni 28 (mbledhjet e përbashkëta të disa komisioneve)

Komisionet e përhershme mund të organizojnë edhe mbledhje të përbashkëta dhe të drejtohen nga njëri nga kryetarët e komisioneve pjesëmarrëse, me mirëkuptim.

Në mbledhje të përbashkët çdo komision merr në mënyrë të veçantë, vendime për çështjet e shqyrtuara.

Per çdo projekt, apo akt të veçantë që shqyrton komisioni, bën raportin e vet që ia paraqet këshillit në kohën e shqyrtimit të aktit.

Raportimi para këshillit bëhet nga një anëtar i komisionit që përcaktohet nga komisioni me propozim të drejtuesit të tij.

Në raport pasqyrohen të gjitha qëndrimet e mbajtura , për problemin e dhënë si dhe shumica e votuesve , me të cilin është marrë vendimi i komisionit.

Në mbledhjet e komisioneve të përhershme mbahet protokoll, nga një prej anëtarëve të Komisionit, i cili në fund , firmoset nga kryetari i komisionit ose nga zëvendësi i tij që ka drejtuar mbledhjen.

Nëse materialet nuk shqyrtohen më parë, nga Komisionet përkatëse dhe nëse nuk shoqërohen me relacionin e tyre, ato nuk mund t'i nënshtrohen procedurës së votimit nga Këshilli Bashkiak.

Mosmbledhja e komisioneve përkatëse për shqyrtimin e materialeve, përbën shkelje të kësaj rregulloreje dhe konsiderohet pengesë në ushtrimin e detyrës së Këshillit Bashkiak.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, për raste të përsëritura të mosmbledhjes së komisionit si dhe për mosrelatimin e akteve që ky komision shqyrton, para mbledhjes së Këshillit Bashkiak, merr masa disiplinore për këshilltarët, anëtarë të komisioneve, sipas n. 52 të kësaj Rregulloreje.

Neni 29 (komisionet e posaçme)

Numri i komisioneve të posaçme të përcaktuara në këtë rregullore është 5 (pesë).

Ky numër mund të ndryshojë, me krijimin e komisioneve të posaçme për nevoja konkrete të KB.

Mënyra e krijimit dhe e funksionimit të komisioneve të posaçme është e njëjtë me atë të komisioneve të përhershme.

#### IV. FUNKSIONIMI I KËSHILLIT BASHKIAK

Neni 30 (Mbledhja e këshillit)

Këshilli i Bashkisë thirret në mbledhje nga Kryetari i Këshillit dhe njoftimi për mbledhje, bëhet si rregull, jo me pak se 5 dite para datës së zhvillimit të saj.

Mbledhjet e radhës së KB do të zhvillohen të enjten e fundit të çdo muaji, në orën 14.00 , në respektim të n. 31 të Ligjit 8652, dt. 31.07.2000 "për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar.

Këshilli i Bashkisë mund të thirret, për nevoja të ngutshme edhe në mbledhje jashtë radhe, të cilat do të njoftohen 3 ditë para datës së mbledhjes. Mbledhjet jashtë radhe do të zhvillohen pas orarit zyrtar të punës në administratën shtetërore, prej orës 16.00 dhe në vijim.

Mbledhjet jashtë radhe mund të thirren me kërkesë të:

-Kryetarit të Bashkisë

-me kërkesën e 1/3 së anëtarëve të KB

-me kërkesën e motivuar të Prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.

Njoftimi i mbledhjeve të KB, përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës.

Mbledhjet e KB quhen të vlefshme, kur në to marrin pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve, sipas përcaktimeve të n. 33 të Ligjit 8652, dt. 31.07.2000 " për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar.

Neni 31 (mënyra e njoftimit të këshilltarëve për mbledhjet e KB)

Njoftimet për mbledhjen e radhës së KB, apo edhe për mbledhjet jashtë radhe, u njoftohen këshilltarëve, nga sekretari i Këshillit Bashkiak, të paktën në mënyrë elektronike (me email), apo me telefon (me sms), dhe në pamundësi të tyre, nëpërmjet shërbimit postar.

Secili këshilltar ka detyrimin të konfirmojë pjesëmarrjen ose jo, në mbledhjen e ardhshme të KB, pas marrjes së njoftimit, si dhe të japë arsyet e mosparaqitjes së tij në rast mungese, nëpërmjet postes elektronike, sms, apo nëpërmjet kthimit të konfirmimit me postë.

Njoftimet dhe konfirmimet e kthjera, administrohen nga sekretari i KB, dhe bëhen prezent në fillim të çdo mbledhje të KB, pas bërjes së apelit nga Kryetari i Këshillit.

Ndërsa materialet e radhës që do shqyrtohen në KB, u dërgohen këshilltarëve përveç, komisioneve, në mënyrë elektronike si dhe me postë, në formë të printuar.

Së bashku me konfirmimin e njoftimit të mbledhjes dhe pjesëmarrjes, këshilltarët konfirmojnë edhe marrjen në dorëzim të materialeve të mbledhjes.

Formulari tip i njoftimit me konfirmim, përpilohet nga sekretari i KB dhe miratohet nga Kryetari i KB dhe u dërgohet këshilltarëve para çdo mbledhje në formë elektronike apo me postë.

Konfirmimet e këshilltarëve që dërgohen me sms, pasqyrohen në nje procesverbal, i cili nënshkruhet nga sekretari i KB, si dhe nga dy këshilltarë të tjerë, anëtarë të të paktën dy grupimeve të ndryshme politike, dhe bëhen prezent në fillim të çdo mbledhje të KB, pas bërjes së apelit nga Kryetari i Këshillit.

Neni 32 (Njoftimi i publikut për mbledhjet e KB)

Mbledhjet e KB i njoftohen publikut të gjerë nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit.

Mbledhjet e KB janë publik, me dyer të hapura, me përjashtim të rasteve, kur këshilli me shumicë votash të këshilltarëve të pranishëm në mbledhje, vendos zhvillimin e seancave të mbyllura.

Vendimet që kanë të bëjnë me buxhetin diskutohen kurdoherë në mbledhje publike.

Propozimi për mbledhje të mbyllura mund të bëhet nga kryetari i KB si dhe nga çdo këshilltar, duke argumentuar problemin dhe propozimin e bërë.

Personat e jashtëm në kohën e mbledhjes së KB, qëndrojnë në vendet e përcaktuara për ta dhe nuk kanë të drejtë të shkelin rregullat e mbledhjes, për çfarëdo lloj arsyeje.

Kryetari i mbledhjes vendos rregull dhe qetësi dhe mund të urdhërojë që persona të veçantë që pengojnë zhvillimin e mbledhjes të nxirren jashtë ambienteve ku po zhvillohet mbledhja dhe të mos lejohen për t'u rifutur.

Neni 33 (Detyrat e KB, sipas n. 32 te Ligjit 8652 dt. 31.07.2000 " për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar)

Këshilli Bashkiak, ka këto detyra :

- a. Miraton statutin e Bashkisë si dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të vet, si dhe Kodin e Etikës.
- b. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin, zëvendëskryetarin e KB
- c. Emëron dhe shkarkon sekretarin e KB.
- ç. Miraton nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

- d. Miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe personave të tjerë juridike që krijon vete, ose është bashkëthemelues.
- dh. Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Ne vendimin për miratimin e buxhetit miraton gjithashtu edhe numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të Bashkisë.
- e. Miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave , të tretëve.
- ë. Organizon dhe mbikeqyr kontrollin e brendshëm të Bashkisë
- f. Vendos për taksat dhe tarifatat vendore, si dhe nivelin e tyre.
- g. vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve.
- gj. Vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të qeverisjes vendore, përfshi subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë.
- h. vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet.
- i. zgjedh përfaqësuesit e Këshillit bashkiak në Këshillin e Qarkut.
- j. vendos për dhënien ose heqjen e mandatit të këshilltarit të KB.
- k. miraton norma, standarte dhe kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.
- l. vendos për simbolet e Bashkisë
- ll. vendos për emërtimin e rrugëve, të shesheve, të territoreve të institucioneve, dhe të objekteve në juridiksionin e Bashkisë.
- m. jep tituj nderi dhe stimuj.
- n. vendos për rregullat, procedurat, dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe në zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim tek Bashkia.

#### Neni 34 (Procedura e zhvillimit të mbledhjes së KB)

Kryetari i KB, pasi bën apelin e këshilltarëve, çel mbledhjen, kur është siguruar pjesëmarrja e më shumë se gjysmës së numrit të përgjithshëm të këshilltarëve.

Kryetari i KB, pezullon mbledhjen, nëse nuk sigurohet pjesëmarrja e më shumë se gjysmës së numrit të përgjithshëm të këshilltarëve.

Kryetari i KB, në rast të mosformimit të kuorumit të nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes, njofton datën e mbledhjes së radhës, si dhe projekt rendin e ditës për mbledhjen e ardhshme.

Me propozim të Kryetarit të Këshillit, këshilli miraton një program tremujor ose vjetor të mbledhjeve dhe çështjeve që do të shqyrtojë.

#### Neni 35 (ndryshimi i rendit të ditës)

Këshilltarët mund të propozojnë ndryshime për rendin e ditës, pas shpalljes së projektit të tij, në mbledhjen e KB, pas shpërndarjes së thirrjes për mbledhjen e ardhshme, por si përjashtim, këshilltarët mund të propozojnë për të përfshirë në rendin e ditës, probleme të motivuara, edhe ditën e mbledhjes.

Këto propozime për ndryshimin e rendit të ditës, votohen me votim të hapur në fillim të mbledhjes dhe vendimi merret me shumicën e votave të këshilltareve të pranishëm.

Zakonisht këshilli shqyrton vetëm problematikat që janë pjesë e rendit të ditës.

#### Neni 36 (menyra e diskutimit në mbledhjet e këshillit)

Kryetari drejton mbledhjen dhe u jep fjalën këshilltarëve, sipas radhës së kërkimit të saj. Asnjë këshilltar nuk mund të diskutojë pa ju dhënë kjo e drejtë nga Kryetari i KB.

Fjala kërkohet me ngritjen e dorës nga vendi, ose paraprakisht me shkrim.

Kryetari harton listën me emrat e këshilltarëve që kanë bërë kërkesë për diskutim dhe përcakton radhën e diskutimeve në përputhje me kohën e bërjes së kërkesës.

Për çështjet proceduriale fjala jepet menjëherë. Çështje proceduriale konsiderohen çështjet që kanë të bëjnë me propozime për ndryshime apo plotësime në rregullin e zhvillimit të mbledhjes.

Këshilltarët flasin në foltore, ose nga vendi.

Nëse këshilltari që ka marrë fjalën shmanget nga tema e diskutimit, i tërhiqet vëmendje nga Kryetari i KB dhe nëse shkelja vazhdon, atij i hiqet e drejta e fjalës për diskutimin e atij problemi të rendit të ditës.

Këshilltari nuk mund të diskutojë më shumë se një herë për problemin që mund të diskutohet, sipas rendit të ditës.

Këshilli përcakton edhe kohëzgjatjen e një diskutimi, në fillim të mbledhjes, me votim të hapur. Nëse diskutimet zgjasin tej kohës së përcaktuar, këshilltarit i hiqet e drejta e fjalës.

#### Neni 37 (replika )

Replika është një qëndrim i paraqitur shkurtimisht për përmbajtjen e një diskutimi të përfunduar. Replika bëhet menjëherë pas diskutimit dhe nuk mund të vazhdojë më shumë se 1 minutë. Për të njëjtin diskutim mund të behen jo më shumë se 2 replika .

Pas paraqitjes së replikave, këshilltari që ka diskutuar ka të drejtën e përgjigjes me një afat 2 minuta.

Neni 38 (diskutimet e Kr. të Bashkise apo nënkryetarit të saj)

Kryetari dhe zv.Kryetari i Bashkisë, mund të marrin fjalën për diskutim sa herë që e kërkojnë, por vetëm njëri prej tyre mund, për problemin që diskutohet.

Të njëjtën të drejtë e kanë edhe drejtuesit apo këshilltarët e caktuar në emër të grupimeve të këshilltarëve.

Neni 39 (përfundimi i debatit)

Kur lista emërore e këshilltareve diskutante, ka përfunduar, dhe asnjë këshilltar nuk kërkon të diskutojë, Kryetari shpall mbylljen e debatit.

Në rastet kur nga këshilltarët , paraqitet kërkesë për të ndërprerë debatin apo për të shtyrë debatin, përpara votimit, fjala i jepet një këshilltari që nuk është dakord me propozimin e bërë.

Propozimi për ndërprerjen e debatit hidhet në votë, përpara propozimit për shtyrjen e debatit.

Nëse pranohet propozimi për ndërprerjen e debatit, por ka kryetarë grupesh që nuk kanë diskutuar për problemin në debat, fjala i jepet njërit nga këshilltarët për çdo grupim politik.

Neni 40 (Ndërprerja e mbledhjes së KB)

Nëse gjatë zhvillimit të mbledhjes së KB, prishet rregulli dhe qetësia dhe pengohet zhvillimi i qetë i mbledhjes, Kryetari i KB mund të ndërpresë mbledhjen për 30 minuta dhe vetëm njëherë.

Mbledhja mund të shtyhet me Vendim të Këshillit, me propozim të Kryetarit të KB, ose të nje grupi këshilltarësh.

Neni 41 (Regjistrimi i mbledhjes se KB)

Mbledhja e KB, regjistrohet nëpërmjet procesverbalit , i cili mbahet nga Sekretari i KB.

Procesverbali mund të mbahet edhe në menyre elektronike, me mjete incizimi.

Procesverbali i mbajtur me shkrim, firmoset në fund të mbledhjes nga Sekretari dhe kryetari i KB, dhe administrohet nga Sekretari i KB.

Regjistrimet me mjete të tjera, zbardhen me shkrim nga sekretari dhe nënshkruhen nga Sekretari dhe kryetari i KB. Regjistrimi i mbledhjes ne Cd, ruhet deri ne nje vit.

Neni 42 (Nënshkrimi i akteve të miratuara në këshill dhe hyrja ne fuqi e tyre)

Të gjitha aktet që miraton Këshilli, nënshkruhen brenda 5 ditëve nga data e miratimit te tyre. Në rastet kur janë berë gabime në hedhjen e akteve të këshillit, korrigjimi i tyre bëhet me Urdhër të Kryetarit të KB, mbasi deëgjohet paraprakisht titullari që ka paraqitur aktin si dhe referuesi nga Komisioni perkates i Këshillit.

Aktet e KB shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tyre. Çdo akt parashikon edhe mënyrën e shpalljes , në stendën e njoftimeve të Bashkisë, apo në faqen zyrtare të saj.

Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi, në datën e njoftimit të tyre, subjekteve që përfshihen në to.

#### Neni 43 (Votimi)

Votimi është individual. Votohet me "pro", "kunder" dhe "abstenoj".

Votimi kryhet i hapur ose i fshehtë.

Votimi i hapur kryhet nëpërmjet ngritjes së dorës, me votim të përgjithshëm ose me votim nominal, emër për emër. Me votim nominal Sekretari i KB, therret emër për emër këshilltarët, dhe secili këshilltar përgjigjet me " pro", "kundër", "abstenoj".

Votimi i fshehtë kryhet me fletëvotimi.

Fletët e votimit hartohen drejtpërdrejt në Këshill.

Për organizimin e votimit ngarkohet sekretari i KB, ose formohet një komision i veçantë për shqyrtimin e votimit, si rregull me përfaqësues nga grupimet politike në këshill, në referim të n. 20 të kësaj rregulloreje.

Çdo këshilltar ka të drejtën e propozimit, për përcaktimin e mënyrës së votimit. Propozimi hidhet në votë pa debat.

#### Neni 44 (Proçesi i votimit)

Kryetari i KB shpall fillimin e proçesit të votimit. Gjatë procesit të votimit nuk i jepet fjala asnjë këshilltari.

Sipas nevojës drejtuesit e grupimeve politike, mund të kërkojnë para fillimit të votimit të terhiqet grupimi, për konsultim, me një afat deri në 10 minuta.

Aktet në fillim votohen në parim. Për çdo propozim të bërë, sipas radhës së paraqitjes, bëhet votimi.

Në rastin kur kërkohet, dhe vendos Këshilli, votimi bëhet veças për çdo pikë të projektit të paraqitur. Në këto raste, në fillim hidhet në votë, propozimi për heqjen fare të pikës(kur ka propozime të tilla) dhe pastaj votohet për plotësimet dhe ndryshimet e tij.

Propozimet quhen të miratuara, kur për to voton me shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm.

Vendimet sipas n. 32 të Ligjit 8652, merren sipas përcaktimeve të n. 33 të ndryshuar të Ligjit 8652.

Në raste të parregullsive në votim si dhe në rastet e votimit me rezultat të barabartë " pro" e "kunder", votimi përsëritet. Ky i fundit është përfundimtar.

Në rastet kur nuk votohet "pro" me shumicë të votave, propozimi quhet që nuk miratohet dhe hiqet nga vendimi.

#### Neni 45

Kryetari i Bashkisë, komisionet e përhershme, këshilltare të veçantë, paraqesin në këshill, projekt vendime dhe projekt urdhëresa.

Projektet së bashku me relacionet përkatëse, ku jepen sqarime, për motivet e propozimit të aktit dhe me mënyrën e zgjidhjes së çështjeve të veçanta, i drejtohen Kryetarit të Këshillit Bashkiak dhe regjistrohen në librin e akteve të Këshillit.

#### Neni 46 (Shpërndarja e projekteve komisioneve të përhershme)

Kryetari i KB, nëpërmjet sekretarit të këshillit, u shpërndan projektet e paraqituara, komisioneve të përhershme, në përputhje me karakterin dhe përkatësinë e tyre, duke përcaktuar cili komision do jetë "kryesor" në paraqitjen e relacionit për projekt-vendimet në këshill.

Komisioni "kryesor", organizon dhe koordinon punën, për shyrtimin e projektit dhe ndjek ruajtjen e afateve dhe përgatit raportin për mbledhjen e këshillit.

Komisionet e tjera "të interesuara", japin mendime për projektet e marra dhe ja drejtojnë ato Kryetarit të KB, nëpërmjet sekretarit të KB, gjithmonë përpara ditës së shqyrtimit të projektit në këshill.

Komisionet e përhershme në raportet që paraqesin, deklarohen për domosdoshmërinë e aktit, dobinë e tij, mundësitë financiare, si dhe propozojnë plotësime të tij.

Ato bëjnë propozime të argumentuara para këshillit, për të pranuar projektin ashtu siç është, apo duke i bërë ndryshime, plotësime apo për të mos e miratuar atë.

Kur paraqitësi i projektit nuk është dakord me raportin e komisionit, ai mund të paraqesë në këshill një raport plotësues.

#### Neni 47

Projekt-vendimet dhe projekt-urdhëresat shqyrtohen në këshill, pas raportimeve që bëjnë paraqitësit dhe komisionet përkatëse.

Në raste të mosparaqitjes së raportit nga paraqitësi dhe komisionet përkatëse, këshilli duhet të bindet për domosdoshmërinë e aktit dhe të projektit të paraqitur.

#### Neni 48 (Kthimi i projekteve për rishqyrtim)

Kur këshilli e sheh të arsyeshme merr vendim për rishqyrtimin e projektit, mbasi ai të plotësohet me tej.

Në këtë rast përcaktohet koha e rishqyrtimit, dhe sipas rastit mund të parashikohet rishqyrtimi i tij, duke u futur në rëndin e ditës, në mbledhjen e radhës së KB.



Në këtë rast për plotesimet që do të bëhen, ndiqet e njëjta rrugë përgatitore si me projektin fillestar. Projekti fillestar nuk i jepet paraqitesit, me përjashtim të rastit kur bie dakord vetë këshilli, me të drejtë që edhe raporti i parë, t'i rikthehet këshillit.

Neni 49 (Pyetjet e këshilltarëve ndaj Kryetarit të Bashkisë)

Këshilltarët në mbledhjen e këshillit mund t'i drejtojnë pyetje Kryetarit të Bashkisë ose zëvendësit të tij. Pyetjet duhet të jenë të qarta, të shkurtra dhe të kërkojnë informatat e domosdoshme për sqarimin e problemeve.

Kur për problemet që bëhen pyetje, nevojitet kohë për nxjerrjen e të dhënave sqaruese, pyetjet bëhen jo më vonë se një ditë para zhvillimit të mbledhjes së KB.

Në këto raste pyetjet i drejtohen me shkrim Kryetarit të Bashkisë.

Në të kundërt nëse nuk zbatohet afati i drejtimit të pyetjeve, Kryetari i Bashkisë, ka të drejtë të kërkojë kohën e duhur për përgatitjen e të dhënave.

Në keto raste në mbledhje të Këshillit futet në rend të ditës, dhënia e përgjigjeve të pyetjeve të Kryetarit të Bashkisë, apo personi tjetër i autorizuar prej tij.

Këshilltari që pyet ka të drejtë të shprehet nëse përgjigjen nga Kryetari i Bashkisë e do me shkrim apo me gojë.

Ne rastet kur mungon këshilltari që ka bërë pyetjen, Kryetari nuk i përgjigjet pyetjes së bërë prej tij, duke e shtyrë për mbledhjen pasardhëse.

Autori i pyetjeve mund të tërheqë pyetjet e bëra, më parë, duke u deklaruar në mbledhje ose duke e paraqitur tërheqjen me shkrim.

Kur fillohet nga përgjigjia e pyetjeve, këshilltari që pyet mund të kërkojë paraprakisht të sqarojë ndonjë çështje që lidhet me shkaqet përse i ka lindur pyetja.

Neni 50

Kryetari i Bashkisë ose zëvendësi i tij, të cilit i është bërë pyetja, jep përgjigje me gojë ose me shkrim. Në rastet kur ai nuk është në gjendje të përgjigjet, jep sqarime të nevojshme për këtë.

Mbas përfundimit të përgjigjeve, këshilltari që ka bërë pyetje ka të drejtë të bëjë pyetje plotësuese për sqarimin e problemeve.

Gjatë përgjigjes së pyetjeve, nuk lejohet të bëhet debat.

Mbas përgjigjes së dhënë, këshilltari që ka bërë pyetjen ka të drejtën e replikës duke dhënë konsideratën e tij për përgjigjen e dhënë.

Neni 51

Kryetari i Bashkisë mund të mos paraqitet në mbledhjen e KB.

Në rastet kur këshilli e sheh të nevojshme pjesëmarrjen e Kryetarit të Bashkisë, e fton atë, për paraqitje personalisht para Këshillit.

Neni 52. (Mosparaqitja e këshilltarëve në mbledhjet e këshillit)

Nëse këshilltarët, pas njoftimit të tyre sipas mënyrës së përcaktuar në këte rregullore, nuk paraqiten në mbledhjet e KB, kanë detyrimin të paraqesin justifikim e arsyeshëm para Kryetarit të Këshillit Bashkiak.

Këshilltarët lejohen të bëjnë deri në katër mungesa të arsyeshme gjatë gjithë veprimtarisë së KB, brenda 1 viti kalendarik.

Çdo mungesë e arsyeshme mbi këtë numër do shoqërohet me ndërprerje të shpërblimit të këshilltarit.

Këshilltarët për mungesat e paarsyeshme dhe të panjoftuara kryetarit të KB, penalizohen me ndërprerje të shpërblimit që përfitojnë si këshilltarë.

Neni 53 (Miratimi dhe monitorimi i zbatimit të Kodit të Etikës)

Miratimi i Kodit të Etikës, bëhet nga KB, sipas procedurës së miratimit të akteve të tjera.

Ai miratohet me shumicën e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve të KB.

Monitorimi i zbatimit të kodit të etikës bëhet nga Komisioni i posaçëm i etikës dhe disiplinës, i cili merr në shqyrtim të gjitha shkeljet e këtij kodi dhe propozon para kryetarit të këshillit, masat përkatëse për këshilltarët që shkelin këtë kod.

Këshilltarët që shkelin në mënyrë të përsëritur Kodin e Etikës, penalizohen nga Kryetari i Këshillit duke mos u lejuar të marrin pjesë në dy mbledhje radhazi të KB, duke u konsideruar si mosparaqitje pa shkaqe të arsyeshme.

Shkeljet e kodit të etikës, dokumentohen në procesverbale të posaçme dhe administrohen nga sekretari i KB.

Neni 54 (Heqja e mandatit të këshilltarit, për mosparaqitje)

Përveç parashikimeve të tjera të n. 27 të Ligjit 8652, këshilltari që nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6 mujore, i hiqet mandati me propozim të komisionit të mandateve.

Heqja e mandatit të këshilltarit, i njoftohet paraprakisht këshilltarit, Këshillit, nga Komisioni i mandateve, dhe propozohet për t'u futur në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme të këshillit dhe i nënshtrohet votimit të fshehtë.

Vendimi merret me shumicën e këshilltarëve të pranishëm në mbledhjen e radhës ku diskutohet heqja e mandatit.

Këshilltari që mbaron mandatin para afatit, për shkak të mosparaqitjes së tij, zëvendësohet me këshilltarin e radhës, sipas listës shumëemërore të të njëjtit grupim politik.

Neni 55 (Dokumentacioni që administron sekretari i këshillit në lidhje me pjesëmarrjen e këshilltareve në mbledhjet e KB).

Në fillim të çdo mbledhje të KB, bëhet apeli i këshilltarëve dhe pasqyrohen në një procesverbal, mungesat e këshilltareve si dhe arsyet e mungesave të tyre, si dhe shkakut i mospjesëmarrjes.

Kryetari i KB vlerëson nëse mungesa është e arsyeshme apo jo dhe e pasqyron edhe këtë fakt në këtë procesverbal.

Komisioni i mandateve në përfundim të periudhës 6 mujore të veprimtarisë së këshillit, verifikon nëse jemi në kushtet e mbarimit të mandatit të ndonjë këshilltari, për mosparaqitje, dhe bën propozimet përkatëse, në zbatim të n. 53 të kësaj rregulloreje.

Neni 56 (Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me të tretët)

KB përfaqësohet para Gjykatës, me autorizim të posaçëm të Kryetarit të KB, sipas modelit bashkëngjitur kësaj rregulloreje .

KB merr në shqyrtim , nëpërmjet komisionit të shqyrtimit të ankesave të qytetarëve, ankesat dhe kërkesat e tyre që janë kompetencë e vendimmarrjes së tij dhe shprehet me vendim në mbledhjet e tij të radhës.

Ankesat apo kërkesat protokollohen në një libër të veçantë nga sekretari i KB, i përcillen Komisionit të ankesave, dhe ky i fundit raporton para KB në mbledhjen e radhës.

Vendimmarrja e KB mund të jetë individuale për secilën ankesë ose në grup, kur ankesat kanë të njëjtën problematike.

Neni 57 (Miratimi i akteve të tjera në zbatim të rregullores)

KB mund të miratojë edhe akte të tjera, në zbatim të kësaj rregulloreje.

Neni 58

Kjo rregullore miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e KB dhe hyn në fuqi sipas ligjit.

Neni 59

Rregullorja e miratuar me Vendimin nr. 28 dt. 04.04.2001 të KB, shfuqizohet.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ILIR BAJLOS